

VENDIM
Nr. 603, datë 8.9.2006

**PËR RREGULLAT DHE VEPRIMET E ZYRAVE TË GJENDJES CIVILE, PËR
TRANSFERIMIN E TË DHËNAVE TË GJENDJES CIVILE TË SHTETASVE, TË
REGJISTRUAR NË REGJISTRIN E PËRKOHSHËM**

(Ndryshuar me VKM nr. 627, datë 23.9.2006)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1, 5 e 7, të nenit 12 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, të neneve 21 e 27, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 12, të ligjit nr.9464, datë 22.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimi i të dhënave të gjendjes civile të shtetasve, të regjistruar në regjistrin e përkohshëm, në zbatim të ligjit nr.9296, datë 21.10.2004, “Për verifikimin, identifikimin dhe regjistrimin e shtetasve nga njësitë e qeverisjes vendore”, të bëhet nga zyrat e gjendjes civile të vendbanimit të tyre në zyrat e gjendjes civile, ku janë regjistruar në regjistrin e përkohshëm.

2. Zyrat e gjendjes civile, brenda 2 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të evidentojnë dhe të bëjnë ndarjen e shtetasve, të regjistruar në regjistrin e përkohshëm, sipas zonave të qendrave të votimit, që ndodhen në territorin, që mbulon ajo zyrë e gjendjes civile.

3. Transferimi i të dhënave të gjendjes civile, sipas përcaktimit të pikës 1, të bëhet sipas kësaj procedure:

a) Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, brenda 3 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të caktojnë për territorin e çdo qendre votimi, grupet dyshe të punës, të cilët do të kontaktojnë me shtetasit e regjistruar në regjistrin e përkohshëm. Për qendrat e votimit, që kanë më shumë se 20 familje në regjistrin e përkohshëm, caktohen dy grupe pune. Anëtarët e grupeve dyshe propozohen, përkatësisht, nga dy forcat më të mëdha politike, të përfaqësuara në këshillin përkatës. Grupet e punës pajisen me listën e shtetasve, të regjistruar në regjistrin e përkohshëm të territorit të zonës së qendrës së votimit përkatës, ku për çdo familje, është shënuar adresa shifrore zgjedhore, dhe me hartën e zonës së qendrës së votimit. Grupet e punës, pasi kontaktojnë kryefamiljarët, plotësojnë deklarin e shtetasve për transferimin e të dhënave të gjendjes civile në adresën, ku kanë regjistrin e përkohshëm, sipas formularit 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Grupet e punës, dorëzojnë, çdo ditë, në zyrat e gjendjes civile, deklarin e plotësuar të shtetasve. Nëse kryefamiljarët nuk kontaktohen, grupi i punës lë njoftimin përkatës, në të cilin janë përcaktuar data dhe ora, kur grupi i punës do të vijë përsëri. Ky proces do të përsëritet tre herë. Ky proces kryhet brenda 10 ditëve. Zyrat e gjendjes civile marrin dhe administrojnë edhe deklarin e, të cilat mund të bëhen vullnetarisht nga shtetasit gjatë gjithë kohës së këtij procesi.

b) Me marrjen e deklarimeve të shtetasve, zyra e gjendjes civile, ku shtetasit kanë regjistrin e përkohshëm, i kërkon zyrtarisht, sipas formularit model 1, zyrës së gjendjes civile të vendbanimit, dokumentin përkatës (fletëfamiljen) me të dhënat e gjendjes civile të shtetasit/ve. Ky proces kryhet në të njëjtën ditë me dorëzimin e deklarimeve.

c) Zyrat e gjendjes civile, me plotësimin e formularit, bëjnë dorëzimin, çdo ditë, të formularit model 1 për zyrat e gjendjes civile, brenda të njëjtës njësi vendore. E njëjta procedurë ndiqet dhe për njësitë bashkiake të Tiranës, si dhe për bashkitë dhe komunat, që mund të jenë kufitare me njësinë vendore. Për njësitë e tjera, dorëzimi bëhet brenda ditës në degët e gjendjes civile në rreth, të cilat brenda të njëjtës ditë bëjnë shpërndarjen e këtij dokumentacioni për në zyrat

e gjendjes civile të njësive vendore të të njëjtit rreth. Formularët, që u përkasin njësive të tjera të qeverisjes vendore, dorëzohen brenda ditës në zyrën e gjendjes civile në qark. Zyra e gjendjes civile në qark u dërgon, brenda 24 orëve, formularin model 1, zyrove të gjendjes civile në rreth, të cilat e dërgojnë brenda ditës në njësitet vendore përkatëse. Zyra e gjendjes civile në qark dërgon, jo më vonë se 24 orë në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile formularët model 1, që u përkasin njësive të qeverisjes vendore të qarqeve të tjera. Ky proces kryhet jo më vonë se 3 ditë, nga mbarimi i afateve të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 3, të këtij vendimi.

ç) Zyra e gjendjes civile e vendbanimit, me marrjen e kërkesës, plotëson formularin model 2 dhe fletëfamiljen. Ky proces duhet të kryhet jo më vonë se 7 ditë nga mbarimi i afateve të përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 3, të këtij vendimi.

d) Zyrat e gjendjes civile, me mbarimin e procesit, dorëzojnë, sipas procedurave të parashikuara në shkronjën “c”, të pikës 3, në degët e gjendjes civile në rreth, formularët model 2, së bashku me fletëfamiljet e shtetasit/ve. Degët e gjendjes civile në rreth bëjnë shpërndarjen e këtij dokumentacioni. Ky proces kryhet jo më vonë se 3 ditë nga mbarimi i afateve të përcaktuara në shkronjën “ç”, të pikës 3, të këtij vendimi.

dh) Zyra e gjendjes civile, ku shtetasi ka regjistrin e përkohshëm, pasi merr fletëfamiljen e shtetasit/ve, bën regjistrimin e tyre në regjistrin themeltar dhe njofton zyrtarisht zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të mëparshëm, sipas formularit model 3, për çregjistrimin e shtetasit nga regjistri i mëparshëm themeltar. Ky proces të përfundojë jo më vonë se 7 ditë nga mbarimi i afateve të përcaktuara në shkronjën “c”, të pikës 3, të këtij vendimi.

e) Zyrat e gjendjes civile, me plotësimin e formularit model 3, i dorëzojnë ato, sipas procedurave të parashikuara në shkronjën “c”, të pikës 3, në degët e gjendjes civile në rreth. Degët e gjendjes civile në rreth bëjnë shpërndarjen e këtij dokumentacioni. Ky proces të kryhet jo më vonë se 3 ditë nga mbarimi i afateve të përcaktuara në shkronjën “dh”, të pikës 3.

ë) Zyra e gjendjes civile e vendbanimit të mëparshëm, me marrjen e formularit model 3, bën çregjistrimin e shtetasve, duke shënuar në regjister adresën e re të shtetasit dhe për këtë njofton zyrtarisht, sipas formularit model 4, prefektin e qarkut dhe degën e mobilizimit ushtarak. Ky proces kryhet jo më vonë se 4 ditë nga mbarimi i afateve të përcaktuara në shkronjën “e”, të pikës 3.

4. Prefektët janë përgjegjës për kontrollin dhe shpërndarjen e dokumentacionit ndërmjet njësive të qeverisjes vendore. Brenda të njëjtit rreth komunikimi kryhet nga degët e gjendjes civile në rreth. Komunikimi, në nivel qarku, të kryhet nga zyra e gjendjes civile në qark. Në qarqe të ndryshme prefektët shkëmbejnë dokumentacionet, sipas shkronjave “c”, “dh” dhe “ë”, të pikës 3, në ditë të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Çdo zyrë e gjendjes civile mban një kopje zyrtare të të gjithë dokumentacionit të dërguar dhe të marrë. Gjithashtu, një kopje e të gjithë dokumentacionit të shkëmbyer depozitohet pranë prefektit.

5. *Për të ndihmuar dhe monitoruar procesin, në zyrat e gjendjes civile të bashkiave, të njësive bashkiake të Tiranës apo të komunave me mbi 1000 shtetas në regjistrin e përkohshëm, prefekti cakton një person, me arsim të lartë dhe banues në njësinë e qeverisjes vendore përkatëse, i cili duhet të vrojttojë gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të këtij procesi. Caktimi i personit për vrojtimin e procesit të bëhet sipas rregullit të mëposhtëm:*

Partia më e madhe në opozitë, me kryetarin e bashkisë/komunës ose të njësisë bashkiake për Tiranën, i propozon prefektit personin përgjegjës. Prefekti bën emërimin, sipas propozimeve të partive, jo më vonë se 24 orë nga propozimi.

6. Nëse kryetarët e njësive të qeverisjes vendore nuk kanë caktuar grupet e verifikimit, sipas afatit të përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 3, atëherë prefektët, brenda 24 orëve, i emërojnë këto grupe. Në rast se ndonjëra nga partitë politike nuk ka bërë propozimet për grupet e verifikimit, atëherë prefekti emëron, me iniciativë, grupet e verifikimit.

7. Ministrisë së Brendshme, për mbulimin e shpenzimeve të këtij procesi, i jepet fondi prej 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekësh, i cili do të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, për vitin 2006. Ky fond do të përdoret, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi, si më poshtë vijon:

a) Për pagesën e grupeve të punës, të cilët do të kontaktojnë dhe plotësojnë deklaratimet e

shtetasve;

b) Për pagesën e personave, të cilët do të plotësojnë formularët model 1, 2, 3 e 4 dhe do të regjistrojnë shtetasit në regjistrin themeltar;

c) Për mbulimin e shpenzimeve operative të zyrave të gjendjes civile në bashki/komunë, rreth dhe qark, si edhe të zyrës së prefektit;

ç) Për mbulimin e shpenzimeve për vrojtuesit e procesit, të përcaktuar në pikën 7;

d) Për mbulimin e shpenzimeve për lëvizjen dhe shkëmbimin e dokumentacionit;

dh) Për mbulimin e shpenzimeve operative për Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Ministrinë e Brendshme.

8. Transferimi i të dhënave të gjendjes civile të shtetasve, të regjistruar në regjistrin e përkohshëm, sipas këtij vendimi, bëhet pa pagesë.

9. Ky vendim i shtrin efektet, për transferimin e të dhënave të gjendjes civile të shtetasve të regjistruar në regjistrin e përkohshëm, në çdo rast, brenda datës 20 tetor 2006.

10. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, prefektët, kryetarët e bashkive, komunave dhe kryetarët e 11 njësive bashkiake të Tiranës, si edhe zyrat e gjendjes civile në qark, rreth, bashki, komuna dhe njësitë bashkiake të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha



Republika e Shqipërisë
Bashkia/Komuna
Zyra e Gjendjes Civile

Prot.Nr. _____

Model 1

_____ më, ____ / ____ / 2006

KËRKESË

Zyrës së gjendjes civile _____

Në zbatim të pikës 5 të nenit 12 të ligjit nr.8950 dt. 10.10.2002 “ Për gjendjen civile” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr _____, dt _____, kërkojmë të na dërgoni fletëfamiljen e shtetasve:

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Regjistri Themeltar (RTh)			Numri persona	Ndarje nga familja
				Emri RTh	Nr. RTh	Nr. Fletës		
1								
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								

për të bërë transferimin e të dhënave të gjendjes civile të familjeve të tyre , që janë të regjistruar në regjistrin themeltar të zyrës suaj.
Lutemi të na e dërgoni fletëfamiljen brenda afateve të kërkuara.

Shënim: Për shtetasit që kërkojnë ndarje nga familja të bashkëngjitet kopja e kërkesës së tyre për transferimin e të dhënave të gjendjes civile.

Nëpunësi i gjendjes civile _____



Republika e Shqipërisë
Bashkia/Komuna _____
Zyra e Gjendjes Civile

Model 2

Emri, mbiemri, nënshkrimi
_____, më, ____ / ____ / 2006

Prot.Nr. _____

PËRGJIGJE

Zyrës së gjendjes civile _____

Në zbatim të pikës 5 të nenit 12 të ligjit nr. 8950 dt. 10.10.2002 “Për gjendjen civile” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. _____, dt _____ dhe në përgjigje të kërkesës suaj, po ju dërgojmë bashkëlidhur fletëfamiljen e shtetasve sipas të dhënave të mëposhtme:

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Regjistri Themeltar (RTh)			Numri persona
				Emri RTh	Nr. RTh	Nr. Fletës	
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							
8							
9							
10							

për të bere transferimin e të dhënave të gjendjes civile të familjeve të tyre , nga regjistri ynë, në regjistrin themeltar të zyrës suaj.

Lutemi të na dërgoni brenda afateve të kërkuara, njoftimin për veprimet e kryera.

Nëpunësi i gjendjes civile _____



Republika e Shqipërisë
Bashkia/Komuna
Zyra e Gjendjes Civile

Model 3

Emër, mbiemër, nënshkrim
_____ më, ____ / ____ / 2006

Prot.Nr. _____

NJOFTIM

Zyrës së gjendjes civile _____

Në zbatim të pikës 5 të nenit 12 të ligjit nr. 8950 dt. 10.10.2002 “Për gjendjen civile” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr _____, dt _____ dhe në përgjigje të kërkesës suaj, po ju dërgojmë bashkëlidhur konfirmimin e adresës së re të vendbanimit për shtetasit sipas të dhënave të mëposhtme:

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Regjistri Themeltar (RTh)			Numri persona
				Emri RTh	Nr. RTh	Nr. Fletës	
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							
8							
9							
10							

për të bere qregjistrimin e të dhënave të gjendjes civile të familjeve të tyre dhe njoftimin në institucionet që parashikohen në VKM.

Nëpunësi i gjendjes civile

Emër, mbiemër, nënshkrim



Republika e Shqipërisë
Bashkia/Komuna
Zyra e Gjendjes Civile

Model 4

Prot.Nr. _____ më, ____ / ____ / 2006

NJOFTIM

Zyrës së gjendjes civile të degës në qark _____
Degës së mobilizimit _____

Në zbatim të pikës 5 të nenit 12 të ligjit nr.8950 dt. 10.10.2002 “ Për gjendjen civile” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr _____, dt _____, po ju dërgojmë bashkëlidhur konfirmimin e adresës së re të vendbanimit për shtetasit sipas të dhënave të mëposhtme:

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Regjistri Themeltar (RTh)			Numri persona
				Emri RTh	Nr. RTh	Nr. Fletës	
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							
8							
9							
10							

Mbyllet me nr. rendor _____

Nëpunësi i gjendjes civile

Emër, mbiemër, nënshkrim



Model 5

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Bashkia/Komuna _____

QARKU _____

Datë: __/__/__

KERKESE

Unë i nënshkruari _____, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar i biri i _____ dhe i _____, i datëlindjes __/__/__, deklaroj se së bashku me pjestarët e tjerë të familjes sime, me përbërjen e mëposhtëme:

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja			Lidhja familjare me deklaruesin
				Data	Muaji	Viti	
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							
8							
9							
10							

që prej datës __/__/__ banoj në adresën e mëposhtëme:

Qarku/Rrethi: _____ Bashkia/Komuna: _____

Rruga: _____

Ndertesa: _____ Hyrja: _____ Apartamenti: _____

Kërkoj që të realizohet transferimi i të dhënave të gjendjes civile të familjes sime.

KUJDES! Nqs në vendbanimin e mëparshëm keni qënë pjestarë në një familje më të madhe, atëherë duhet bërë kërkesa për ndarje. Kjo kërkesë realizohet thjesht duke firmosur më poshtë brenda këtij seksioni.

Kërkoj ndarjen nga familja e mëparshme së bashku me pjestarët e sipërshtunuar të familjes sime. _____

FIRMA

PO

JO

Shënoni në një nga katrorët e mësipërm

Deklaruesi

(Emri, Mbiemri, Firma)

Plotësohet nga verifikuesët në teren

U konfirmuan deklaratimet e mësipërm duke rezultuar të sakta më datë __/__/__

Verifikues

Verifikues

(Emri, Mbiemri, Firma)

(Emri, Mbiemri, Firma)

Plotësohet vetëm nga Zyrat e Gjendjes Civile

Filloi procedura më datë __/__/__

Fletëfamilja e ardhur nga ZGjC Nr. ____ më datë __/__/__ dhe u regjistrua në regjistrin _____, Numër _____, Fleta ____ më datë __/__/__

Punonjësja e Gjendjes Civile (Emri, Mbiemri, Firma)

Formulari Plotësohet me gërma KAPITALE